EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5709
E shtunë, 23 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Bedri Istrefi zgjedhet kryeshef ekzekutiv i Telekomit

FAQE 8

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VAZHDOJNË MOSPAJTIMET NË MES TË PARTERËVE TË KOALICIONIT QEVERISËS RRETH TAKSËS 100 PËR QIND NDAJ PRODUKTEVE TË SERBISË

FAQE 4-5

TAKSA PRITET TË MARRË EPILOG DERI NË FUND TË MUAJIT

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për taksën 100 për qind ndaj produkteve serbe do të marrë epilog deri në fund të këtij muaji ka bërë me dije një burim brenda koalicionit qeverisës. Ndërkaq njohësit e rrethanave politike në vend thonë se epilogu mund të jetë heqja e taksës në marrëveshje me kryeministrin ose PDK-ja do të largohet nga qeveria duke i lënë Haradinajt mandatin për gjetjen e partnerëve të tjerë për formimin e qeverisë. Por, kryeministri Ramush Haradinaj edhe të premten ka përsëritur se taksa nuk do të hiqet deri në njohjen e Kosovës nga Serbia, kurse zyrtarët e PDK-së kanë përmendur edhe mundësinë e zgjedhjeve të reja nëse nuk pezullohet taksa

MINISTRJA HOXHA: PO BËJMË ÇMOS QË LIBERALIZIMI I VIZAVE TË NDODHË SA MË SHPEJT

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se nuk ka ndonjë datë se kur do të mund të liberalizohen vizat për qytetarët e Kosovës. Ajo ka thënë se janë duke bërë çmos që liberalizimi i vizave të ndodhë sa më shpejt. Në konferencën për media, të cilën e ka mbajtur të premten për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), ministrja Hoxha ka theksuar se programi kombëtar për zbatimin e MSA-së për vitin 2018 ka tejkaluar planet

FAQE 3

Majlinda, e artë në Gjermani

FAQE 5

AKTUALE

NJË MARRËVESHJE E KEQE ASNJËHERË NUK PËRFUNDON MIRË

F. 10

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

EULEX-IT KA TRANSFERUAR TEK INSTITUCIONET E KOSOVËS 900 LËNDË TË KRIMEVE TË LUFTËS

F. 7

PDK-ja BËHET ANËTARE E ALEANCËS SË KONSERVATORËVE DHE REFORMISTËVE NË EVROPË

F. 7

EKONOMI

ÇMIMET E PRODHIMEVE BIMORE DHE BLEGTORALE SHËNUAN RRITJE

F. 8

NDËRPRITET GREVA E KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT AJROR

F. 9

KULTURË

KOORDINATORI HOTI TAKOHET ME DREJTORËT E SHKOLLAVE BOSHNJAKE

F. 20

SPORT

'DARDANËT' KËRKOJNË FITORE NDAJ RUMANISË

F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Beteja për kandidatin konsensual për president

Partitë në pushtet në Maqedoninë Veriore ende nuk kanë arritur një marrëveshje për kandidatin e tyre që do të garonte në zgjedhjet presidenciale më 21 prill, kurse opozita vazhdon fushatën me kandidaten e saj për presidente shteti

SHKUP, 22 SHKURT - Derisa opozita në Maqedoninë e Veriut vazhdon fushatën me kandidaten e saj për presidente shteti, partitë në pushtet ende nuk kanë arritur një marrëveshje për kandidatin e tyre që do të garonte në zgjedhjet presidenciale më 21 prill.

Lidhja Social-Demokrate (LSDM) ka vazhduar kontaktet me partitë politike që janë pjesë e Qeverisë, por edhe me ato opozitare shqiptare. Megjithatë, deri më tani pa ndonjë epilog konkret.

Njohësit e çështjeve politike thonë se shumica parlamentare duhet të gjejë një kuadër të profilizuar, mbipartiak, i aftë që të përballet me kandidaten për presidente të VMRO-DPMNE-së, Gordana Siljanovska, një profesoreshë universitare, që konsiderohet konkurrente serioze në garën presidenciale. "Nga fakti që VMRO-DPMNE-ja ka kandiduar një profesoreshë universiteti, e cila, megjithatë, ka një integritet akademik intelektual, do ta detyrojë edhe shumicën parlamentare që të ketë një kandidat serioz, i cili mund të jetë rival i denjë i Siljanovskas. Kjo, nga ana tjetër, do të thotë se partitë politike nuk do ta kenë luksin që për president të kenë njerëz të cilët do të jenë dëgjues të direktivave partiake, por më tepër do të jenë përfaqësues të denjë të interesave të qytetarëve", thotë Naser Zyberi, njohës i çështjeve politike.

Nga LSDM-ja kanë bërë me dije se kanë në opsion më shumë kandidatë që u janë nënshtruar edhe anketave për të gjetur më të mirin të mundshëm, e që do të kishte edhe mbështetjen e partive të tjera në pushtet si nga Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) dhe partitë e tjera të opozitës shqiptare. Si emra të mundshëm përmendën ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, koordinatori nacional për NATO-n, Stevo Pendarovski, ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, duke thënë se ka edhe shqiptarë, por pa saktësuar emra konkretë. Nga BDI-ja kanë thënë se janë për një kandidat konensual, i pranueshëm për të gjitha partitë politike.

Analisti Zyberi thotë se për shkak të kritikave të shumta me të cilat është përballur LSDM-ja nga opozita nuk beson se do ta merrte guximin të dalë në zgjedhje me një kandidat shqiptar. "Mendoj se LSDM-ja nuk do ta ketë guximin për të nominuar kandidat të mundshëm për president ndonjë shqiptar, aq më tepër kur ky subjekt akuzohet nga opozita se e ka shkelur interesin kombëtar me Marrëveshjen e Prespës, Marrëveshjen me Bullgarinë, Ligjin për dygjuhësinë, por edhe me zgjedhjen e Talat Xhaferit për kryetar të Kuvendit", thotë Zyberi.

Petar Arsovski, njohës i çështjeve politike, thotë se partitë po bëjnë përpjekje për të hequr dorë nga praktika e deritanishme e kandidimit të njerëzve të dështuar partiakisht, ndërsa sa i përket përkatësisë etnike të kandidatëve, thekson se perceptimi i qytetarëve ka ndryshuar për dallim nga e kaluara. "Sa i përket përkatësisë etnike të kandidatëve, mendoj se, për dallim nga e kaluara, tani kemi një situatë më të relaksuar dhe bashkësitë etnike pranojnë që kandidati që të jetë i një bashkësie tjetër etnike, por besoj se një kandidat maqedonas për president më mirë do të kalonte te shqiptarët sesa një shqiptar te maqedonasit, kjo për shkak të përqindjes së popullatës", thotë Arsovski.

Kandidatin për president, LSDM-ja ka paralajmëruar se do ta zyrtarizojë më 3 mars në kongresin e partisë. Zgjedhjet presidenciale do të mbahen në dy rrethe zgjedhore, më 21 prill dhe 5 maj. Fushata nis në fillim të prillit dhe zgjat 20 ditë.

Rama: Gati për dialog, por jo për zgjedhje të reja

TIRANË, 22 SHKURT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se shumica ka qenë dhe është e gatshme për dialog me opozitën, por jo për të diskutuar për zgjedhje të reja "përmes një kamikazërie politike mbi mexhlisin e jetës parlamentare".

Në një fjalim të gjatë, ditën kur opozita zyrtarizoi vendimin e saj për lënien e mandateve, dhe iu drejtua shesheve për protestën e radhës duke kërkuar largimin e tij dhe krijimin e një qeverie tranzicioni, kryeministri hodhi poshtë në mënyrë të prerë një mundësi të tillë, e cila do ta bënte vendin, siç u shpreh ai, "një territor të paqeverisshëm kurrë më, nëse futet rregulli i ri i padëgjuar askund në botë, i palexuar kurrë në libra, se kur një opozitë arratiset nga parlamenti, shumica duhet ta ndërpresë mandatin e saj e të shkojë në zgjedhje me qeverinë që i pëlqen opozitës".

Ai tha se kjo është ditë e keqe për demokracinë shqiptare. "Është e dëmshme sa të duash për produktivitetin e jetës sonë politike kjo zgjedhje destruktive e opozitës për të hequr dorë nga mandatet e popullit. Është fatkeqësia e përsëritur e këtij vendi që goditet nga bijë të vetët, kur ka përpara një mundësi reale për t'u ngjitur më lart. Kjo është një goditje që mund edhe të rezultojë fatale për çeljen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian këtë vit", tha Rama.

Kuvendi çon në KQZ dorëheqjet e opozitës

Tiranë, 22 shkurt - Kuvendi i Shqipërisë i ka dërguar kërkesë KQZ-së për t'i bërë zëvendësimet e emrave pas dorëzimit zyrtarisht të mandatit të deputetit nga deputetët e opozitës. Kuvendi ka firmosur të premten 56 dorëzimet e mandateve të opozitës, duke i përcjellë kështu në KQZ, si dhe duke bërë kërkesë për zëvendësimin e emrave të deputetëve të opozitës.

Kuvendi ka vënë në dijeni KQZ-në për vendet e lira të krijuara dy ditë më parë, pas vendimit të deputetëve të opozitës për t'i lënë mandatet e tyre parlamentare.

Sipas rregullores, brenda 30 ditëve KQZ-ja duhet të shprehet për ndërprerjen e mandatit të deputetëve të opozitës si dhe zëvendësimin e tyre.

Ndërkaq, lideri i PD-së, Lulzim Basha, pas kthimit nga Vjena, ka mbledhur kryesinë e partisë. Çështje kryesore diskutimi do të jenë hapat që do të ndërmarrë forca më e madhe e opozitës për vazhdimin e protestës. Nuk dihet ende se çfarë i është komunikuar liderit demokrat në Vjenë dhe arsyet e kthimit të papritur të tij në Shqipëri.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka mbajtur konferencë për media në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA)

Ministrja Hoxha: Po bëjmë çmos që liberalizimi i vizave të ndodhë sa më shpejt

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se nuk ka ndonjë datë se kur do të mund të liberalizohen vizat për qytetarët e Kosovës. Ajo ka thënë janë duke bërë çmos që liberalizimi i vizave të ndodhë sa më shpejt. Në konferencën për media, të cilën e ka mbajtur të premten për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), ministrja Hoxha ka theksuar se programi kombëtar për zbatimin e MSA-së për vitin 2018 ka tejkaluar planet

Shqipe Hetemi

Prishtinë, 22 shkurt - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka mbajtur të premten një konferencë për media, në të cilën ka folur për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Ajo ka thënë se programi kombëtar për zbatimin e MSA-së për vitin 2018 ka tejkaluar planet. "Sipas marrëveshjes sonë me BE-në, për mbështetje buxhetore për reformën e administratës publike, ka qenë e paraparë që zbatimi për vitin 2018 të jetë së paku 60 për qind, ndërkohë që plani është tejkaluar në 68.23 për qind", ka potencuar ministrja Hoxha, ndërsa ka përmendur planet për të cilët janë marrë vesh me BE-në për zbatim, që në vitin 2019 duhet të jetë 70 për qind, ndërsa për vitin 2020 të jetë 80 për qind.

Fondet e BE-së për Kosovën vetëm sa janë rritur: IPA 2017 ka ndarë 73 milionë euro, IPA 2018 ka ndarë 90.5 milionë euro, kurse IPA 2019-2020 afërsisht 200 milionë euro.

Ministrja Hoxha ka thënë se niveli i zbatimit të ERA-s (Agjendës për Reforma Evropiane) për vitin 2018 është 74.07 për qind, duke shtuar se Qeveria e Republikës së Kosovës do të bëjë të pamundurën që këto plane të tejkalohen gjatë vitit 2019 dhe viteve që pasojnë.

Ministrja Hoxha e ka falënderuar BE-në për ndihmën e vazhdueshme që po jep në zbatimin e PKZMSA-së, Agjendës për Reforma Evropiane (ERA), Programit për Reforma Ekonomike, Reformën e Administratës Publike, Menaxhimin e Financave Publike, Fuqizimin e Sundimit të Ligjit dhe shumë fusha të tjera me rëndësi jetike për të ardhmen e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Po ashtu, ministrja i ka njoftuar gazetarët për raundin e 21-të të aplikacioneve në kuadër të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor, vlera e projekteve infrastrukturore tejkalon shumën prej 250 milionë eurosh.

Në fund, gazetarët u interesuan dhe bënë pyetje rreth liberalizimit të vizave, fqinjësisë dhe dialogut si dhe proceset integruese, pyetje të cilave ministrja Hoxha u dha përgjigje. "Liberalizimi i vizave nuk është një çështje që jemi duke heshtur. Do të shohim se cili do të jetë parlamenti i ri në BE. Kemi kërkesa të vazhdueshme që sa më shpejt vendimi të futet në Këshillin e ministrave sepse sapo të përfundojë ky votim çështjet e tjera janë procedurale", ka thënë ministrja Hoxha. Hoxha nuk ka dhënë ndonjë datë se kur do të mund të liberalizohen vizat për qytetarët e Kosovës. "Do të jap data kur të na komunikohet nga Parlamenti Evropian. Këshilli i Ministrave nuk mori vendim. Ne po bëjmë çmos që liberalizimi i vizave të ndodhë sa më shpejt. Tani janë zgjedhjet parlamentare, Brexiti dhe rrethanat janë se nuk e dimë çfarë mund të ndodhë në një të ardhme të afërme" ka thënë Hoxha.

Sidoqoftë, procesi i liberalizimit të vizave ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian ka filluar në vitin 2012. Kosova ka pasur për detyrë t'i plotësojë 95 kritere për ta marrë rekomandimin pozitiv për liberalizim të vizave nga Komisioni Evropian.

Një rekomandim të tillë Komisioni Evropian e ka bërë në korrik të vitit 2018, ndërkaq në shtator të po atij viti, Parlamenti Evropian votoi në favor të liberalizimit të vizave për Kosovën.

Në muajin dhjetor të vitit të kaluar Këshilli i Ministrave nuk e vendosi fare në agjendën e takimit të tyre çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Komisionari për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, ka përmendur vitin 2020, si kohën më optimale kur Kosova do të mund sërish të presë një vendim eventual pozitiv për liberalizimin e vizave.

Haradinaj: Mamusha është shembull i mirë i njerëzve punëtorë

Mamushë, 22 shkurt (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të premten një vizitë pune në Komunën e Mamushës. Ai ka biseduar me banorë të kësaj komune dhe ka takuar kryetarin e Mamushës, Abdylhadi Krasniq, nga i cili ka marrë një mirënjohje. Në fjalën para banorëve të Komunës së Mamushës, ku të pranishëm ishin edhe personalitete të tjera, si kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhilar, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, kryeministri Haradinaj ka thënë se Mamusha është një komunë simbolike, një komunë rurale dhe zonë bujqësore, në të cilën jeton një popull autokton, një komunitet autokton, me shumicë turq të Kosovës. "Mamusha është një shembull i mirë i njerëzve punëtorë, i njerëzve të dashur dhe shumë të respektuar, që kanë respektin për popujt përreth dhe, fatmirësisht, është edhe një urë lidhëse e miqësisë që e ka Kosova me Republikën e Turqisë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Ai gjatë vizitës në këtë komunë ka thënë se ka ardhur për të falënderuar për punën dhe angazhimin që e bëjnë dhe për të mësuar për së afërmi për kërkesat dhe nevojat, duke theksuar se kjo komunë ka një buxhet të vogël dhe të hyrat vetjake po ashtu janë të vogla dhe që veprimtarinë e vet jetësore e bazon në bujqësi dhe perimtari, por që së bashku me qeverinë do të mund të ecet drejt zhvillimit të Mamushës dhe të Kosovës.

Vazhdojnë mospajtimet në mes të parterëve të koalicionit qeverisës rreth taksës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë

Taksa pritet të marrë epil

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për taksën 100 për qind ndaj produkteve serbe do të marrë epilog deri në fund të këtij muaji ka bërë me dije një burim brenda koalicionit qeverisës. Ndërkaq njohësit e rrethanave politike në vend thonë se epilogu mund të jetë heqja e taksës në marrëveshje me kryeministrin ose PDK-ja do të largohet nga qeveria duke i lënë Haradinajt mandatin për gjetjen e partnerëve të tjerë për formimin e qeverisë. Por, kryeministri Ramush Haradinaj edhe të premten ka përsëritur se taksa nuk do të hiqet deri në njohjen e Kosovës nga Serbia, kurse zyrtarët e PDK-së kanë përmendur edhe mundësinë e zgjedhjeve të reja nëse nuk pezullohet taksa

Muhamet KOCI

PRISHTINË22 SHKURT - "Vendimi i Qeverisë së Kosovës për taksën 100 për qind ndaj produkteve serbe do të marrë epilog deri në fund të këtij muaji" ka bërë me dije të premten një burim brenda koalicionit qeverisës. Rreth kësaj teme kanë folur njohësit e rrethanave politike në vend, të cilët kanë paralajmëruar se epilogu i taksës do të ketë dy ose tre variante. Ndërsa zyrtarët e partive të koalicionit qeverisës kanë vazhduar t'i shprehin mospajtimet e tyre rreth taksës.

Analisti Behxhet Shala ka thënë për gazetën "Epoka e re" se sheh dy mundësi për heqjen e taksës. "E para që PDK-ja dhe partnerët e koalicionit të merren vesh me Ramushin për taksën duke votuar në qeveri për taksën, në marrëveshje me Ramushin dhe jo në kundërshtim të Ramushit", ka thënë ai, duke përmendur edhe variantin e dytë. "E dyta që, nëse nuk ka marrëveshje, atëherë PDK-ja të dalë nga qeveria, të bëhet opozitë, duke i lënë Ramushit mandatin për gjetjen e partnerëve të tjerë për formimin e qeverisë. Nuk ma kap mendja se Kadri Veseli dëshiron ta rrëzojë Ramushin sepse, po ta kishte këtë qëllim, moti do të harrohej puna e kësaj qeverie, me taksë apo pa taksë. Jam i bindur se kjo gjendje do të marrë epilog shumë shpejt", është shprehur Shala.

Kurse drejtori ekzekutiv i KIPRED-it, Lulzim Peci, ka bërë thirrje që taksa të pezullohet në mënyrë të kushtëzuar. "Mendoj se taksa duhet të pezullohet në mënyrë të kushtëzuar, ta ndalim lojën e luajtjes 'kile' me njëritjetrin, ta ndërtojmë unitetin e spektrit politik të vendit për negociatat me Serbinë, duke përfshirë këtu edhe pozicionin e qartë për pacenueshmërinë e kufijve shtetërorë. Negociatat me Serbinë nuk janë çështje elektorale, por shtetërore. Si pozita e sotshme, po ashtu edhe ajo e ardhshme, do të detyrohet ta zbatojë po të njëjtën marrëveshje që do të nënshkruhet në mes palëve dhe garantuesve të saj ndërkombëtarë, e cila, me fjalorin e BE-së, quhet 'marrëveshje ligjërisht obliguese", ka thënë Peci.

Në profilin e vet në "Facebook" ai ka shkruar se taksa 100 për qind ndaj mallrave serbe ka

og deri në fund të muajit

dhënë këto dy efekte të rëndësishme: kapacitetin shtetëror të Kosovës që të ushtrojë sanksione ekonomike ndaj Serbisë dhe pavarësinë e tregut kosovar prej mallrave serbe. "Mirëpo, në anën tjetër, taksa 100 për qind nuk i shkakton dëm të madh Serbisë, pasi vetëm rreth 2.8 për qind të eksporteve të mallrave të saj vijnë në Kosovë dhe përmes saj nuk mund të mbrohen kufijtë e vendit. Në anën tjetër, përmes taksës jemi duke i larguar miqtë tanë nga Kosova dhe po ia mundësojmë Vuçiqit që fsheh pas saj mosgatishmërinë e tij për normalizim të plotë të marrëdhënieve dhe njohjen e Kosovës", ka shkruar Peci.

Ndërsa zëvendëskryeministri Fatmir Limaj nuk ka dashur që taksën ta lidhë me afate kohore. "Nga përvoja ime politike afatizimet janë të dëmshme. Ajo duhet të jetë angazhim permanent i përditshëm i institucioneve të Kosovës për t'i mirëmbajtur marrëdhëniet me partnerët tanë", ka thënë Limaj të premten pas takimit që ka pasur delegacioni shtetëror me ambasadorët e huaj të akredituar në Prishtinë. Ai ka treguar se edhe në këtë takim ambasadorët e kanë përmendur çështjen e taksës. "Kanë paraqitur shqetësimet rreth temave të tashme të përditshme por, siç e dini, në delegacionin shtetëror nuk bisedohet për taksën, se nuk është detyrë e delegacionit. Pra, duhet të jemi të kujdesshëm t'i ndajmë temat. Ky dialog e ka mandat dialogun, kurse taksa i takon Qeverisë së Kosovës", ka thënë Limaj.

Megjithatë, zëvendëskryeministri Limaj ka treguar dallimet që ekzistojnë rreth kësaj çështje në mes të partnerëve të koalicionit. "Tashmë e kemi të qartë pozicionin e shteteve të Bashkimit Evropian. Ata kanë dhënë një deklaratë të përbashkët ditë më parë. E kemi të qartë edhe pozicionin e ShBA-së, sikurse që besoj është e qartë që ka këndvështrime të ndryshme nga brenda Kosovës. Po bëhen biseda intensive që ne si Kosovë të shkojmë në dialog dhe ta ruajmë partneritetin me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të ecur drejt përmbylljes së procesit të rëndësishëm për dialog", ka thënë Limaj.

Derisa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, edhe të premten ka përsëritur qëndrimin e tij se taksa ndaj Serbisë do të mbetet në fuqi deri në njohjen reciproke Kosovë - Serbi. "Vendimi është marrë si reaksion ndaj qasjes së Serbisë. Është ditur se ka reaksion në ekonominë e vendit, sidomos në ekonominë prodhuese, por duhet të bëhet kujdes me sipërmarrësit tanë dhe duhet të rritet kontrolli kufitar që mos t'i lejojmë të hyjnë mallrat paligjshëm. Ne i kemi pikëpamjet se është më mirë të hiqet, por besoj se vendimin do ta respektojmë pasi është vendim i Qeverisë", ka thënë Haradinaj gjatë një vizite që ka pasur në Komunën e Mamushës.

Një ditë më parë ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, nuk ka përjashtuar prishjen e koalicionit qeverisës për shkak të taksës ndaj mallrave serbe. Në emisionin "Rubikon" të "KTV"-së ai ka thënë se Qeveria Haradinaj duhet të vendosë nëse dëshiron ta mbajë taksën dhe t'i prish relacionet me ShBA-në apo të marrë drejtim tjetër. "Nëse s'hiqet taksa, duhet të dimë që do të prishen relacionet me ShBA-në. Duhet të vendosim a duam ta mbajmë taksën e t'i prishim relacionet apo të shkojmë në drejtim tjetër. Nuk e duam këtë, por besoj të ecim drejt një pike të përbashkët. S'mund të paragjykojmë se a do të ketë zgjedhje apo çka", ka thënë Tahiri.

Ambasadorët e huaj mbështesin platformën për dialog

Bashkëdrejtuesi i delegacionit shtetëror për bisedime me Serbinë, Fatmir Limaj, ka bërë me dije se ambasadorët e akredituar në Prishtinë i kanë dhënë mbështetje platformës për bisedime. "Pas krijimit të delegacionit shtetëror dhe aktiviteteve që ka bërë për hartimin e platformës dhe krijimit të grupeve punuese, është krijuar përshtypja se Kosova është në angazhim të plotë dhe e gatshme për dialogun e mundshëm me Serbinë. Ky është sinjal shumë pozitiv. Edhe një herë morëm mbështetje nga Zyra e BE-së dhe gjithë ambasadorët si delegacion për ta vazhduar angazhimin tonë në dialog", ka thënë Limaj pas takimit me ambasadorët e huaj. Sipas tij, deri në formimin e këtij delegacioni ka pasur përshtypje se Kosova ka ngecur mbrapa në këtë proces. "Vetë krijimi i delegacionit ka qenë një sinjal i fuqishëm dhe shumë pozitiv për Kosovën. Siç u tha edhe nga ambasadorët, ka qenë një përshtypje se Kosova ka qenë goxha prapa në përgatitjen e dialogut", është shprehur ai.

Platforma për dialog tashmë është miratuar nga delegacioni shtetëror për bisedime dhe ky dokument pritet që në javën e ardhshme të votohet edhe në Kuvendin e Kosovës.

Komisioni parlamentar: Ekzistojnë shkelje në pasqyrat financiare të Zyrës së Kryeministrit

Prishtinë, 22 shkurt - Në mbledhjen e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e cila është mbajtur të premten të kryesuar nga kryetari Driton Selmanaj, është shqyrtuar raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Zyrës së Kryeministrit për vitin 2017.

Driton Selmanaj, deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i cili është kryetar i këtij komisioni, ka përmendur edhe punësimet në Agjencinë e Veterinës pa respektuar rregullat e rekrutimit. "Në këtë raport kemi parë keqpërdorime në kategori të ndryshme, keqpërdorim të mjeteve, pastaj ka punësime në Agjencinë e Veterinës pa respektuar rregullat e rekrutimit, pastaj raportimi i dobët për subvencione, mosrespektimi i marrëveshjes në komuna të ndryshme. Çështje tjetër janë pagesat e dyfishta për fermerët në rastet e sëmundjes gungore të kafshëve", u shpreh Selmanaj.

Përkitazi me këtë, të gjeturat u arsyetuan nga sekretari i përgjithshëm i ZKM-së, Fitim Krasniqi, i cili sqaroi se ato tashmë janë adresuar dhe se, po ashtu, kanë realizuar edhe planin e veprimit. "Zyra e Kryeministrit përbëhet nga shumë agjenci të cilat kanë pavarësi të financave. Pas miratimit të planit të veprimit, ne i kemi adresuar te komisioni. Lidhur me raportin, çka ka të bëjë direkt me Zyrën e Kryeministrit, ne kemi dy rekomandime dhe ka qenë edhe një gabim teknik", tha Krasniqi.

Pas diskutimit për këtë çështje, lidhur me rekomandimet për ZKM-në, komisioni do të vendosë në mbledhjen e radhës. Sekretari i përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, Fitim Krasniqi, ka thënë se e kanë parë raportin dhe se do të ndërmarrin masa. Pikë e rendit të ditës së kësaj mbledhje ishte edhe diskutimi lidhur me ndarjen e mjeteve financiare nga programi (232) shpenzimet e paparashikuara. Duke u shprehur shqetësim nga komisioni lidhur me ndarjen e mjeteve nga ZKM-ja, me theks të veçantë për shënimin e 11-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, komisioni vendosi që për këtë të ftojë në raportim kryeministrin e vendit ose zëvendësit e tij. U kërkua, po ashtu, edhe një raport me shkrim lidhur me këto shpenzime. Krejtësisht në fund, komisioni bëri edhe tërheqjen e shortit për auditimin e raporteve financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike për vitin 2017.

Sylejman Selimit i dhurohet stema e komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari

SKENDERAJ, 22 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur të premten në takim ish-komandantin e përgjithshëm të UÇK-së, gjeneral Sylejman Selimi, i cili ishte i shoqëruar nga kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci. Kryetari Jashari ka thënë se kontributi i gjeneral Selimit është i njohur dhe i vlerësuar nga të gjithë. "Ka vuajtur shumë në këto vitet e fundit, madje edhe në aspektin shëndetësor, por tani duket se qëndron shumë mirë", ka thënë Jashari. Ai ka theksuar se për kontributin që gjenerali ka dhënë në luftën çlirimtare dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës, si kryetari i komunës i ka dhuruar stemën e komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari.

Sekuestrohen rreth 1 600 kilogramë mish në Pejë

PEJË, 22 SHKURT (ER) - Prokuroria Themelore e Pejës ka njoftuar se të premten, në kuadër të planit për luftimin e shitjes së produkteve të dëmshme ushqimore, me kërkesë të kësaj prokurorie dhe koordinimit me Policinë e Kosovës, përkatësisht Stacionin Policor në Pejë, janë bastisur gjashtë lokacione të cilat dyshohet se merren me këtë lloj veprimtarie. Gjatë kësaj bastisje, në të cilën kanë marrë pjesë edhe zyrtarët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, janë sekuestruar dhe shkatërruar rreth 1 600 kilogramë mish, për të cilët palët nuk kishin leje përkatëse dhe nuk i plotësonin kushtet adekuate higjienike.

Prokuroria Themelore në Pejë është e përkushtuar për luftimin e kriminalitetit dhe kërkon nga të gjithë ata që kanë informacione për ushtrimin e veprimtarive ilegale t'i paraqesin në organet e hetuesisë.

Inspektorati mbyll dhjetë lokale të lojërave të fatit në Mitrovicë

MITROVICË, 22 SHKURT (ER) - Drejtoria e Inspeksionit në Mitrovicë, në bashkëpunim me Departamentin e Lojërave të Fatit dhe Policinë, ka bërë inspektime te lokalet e lojërave të fatit dhe bastoreve. Pas verifikimit të tyre janë mbyllur dhjetë lokale që kanë zhvilluar biznesin e lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin.

Ky aksion, të cilit i printe drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, së bashku me Inspektorët e Komunës, të ATK-së dhe me asistim të Policisë së Mitrovicës, kanë inspektuar të gjitha lokalet që zhvillojnë biznesin e lojërave të fatit dhe të bastoreve. Aksioni është zhvilluar në tërë lokacionin e Mitrovicës, aty ku edhe mungonin licencat e punës.

Drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka thënë se mungesa e licencave dhe distanca me shkollën ishte shkaku i ndalesës sepse nuk lejohet zhvillimi i kësaj veprimtarie pa licencë dhe kur nuk është në përputhje me distancën e duhur, largësinë me institucionet arsimore.

Kompania e Mbeturinave "Çabrati" bëhet me dy autofshesa

GJAKOVË, 22 SHKURT (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Çabrati", Berat Hadri, ka bërë me dije se kësaj kompanie po i shtohen kapacitetet e munguara teknike. Ai ka shtuar se, bazuar në një menaxhim efikas dhe racional, kanë arritur që me mjete financiare vetjake t'i blejnë dy autofshesa të cilat do ta ndihmojnë punën e stafit. Hadri ka thënë se këto dy autofshesa qytetit të Gjakovës do t'i ofrojnë një proces të pastrimit bazuar në standarde ndërkombëtare. "Puna jonë për përmirësimin dhe përsosjen e shërbimeve do të vazhdojë me ritëm më të shpejtuar. Ambient i pastër, shëndet i garantuar", ka thënë Berat Hadri, kryeshefi ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Çabrati".

EULEX-i ka transferuar tek institucionet e Kosovës 900 lëndë të krimeve të luftës

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 SHKURT - Prokuroria e Shtetit, në kuadër të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive ligjore, tash e tutje do të ketë në dispozicion një dokument të rëndësisë së veçantë për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës ngaqë anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës kanë aprovuar Strategjinë për raste e krimeve të luftës në mbledhjen e mbajtur më 21 shkurt.

Kjo strategji, hartimi i së cilës është iniciuar nga Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, synon t'i hetojë dhe ndjekë penalisht të gjithë personat të cilët kanë kryer krime lufte në kundërshtim me të drejtën humanitare ndërkombëtare gjatë viteve 1998-1999 në tërë territorin e Republikës së Kosovës si dhe vendosjen e drejtësisë për viktimat.

Një numër i madh i krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të tjera të rënda sipas së drejtës ndërkombëtare, të kryera në formë të vrasjes së civilëve, zhvendosjes së detyruar të popullatës civile, burgosjes së paligjshme, torturës, dhunës seksuale, trajtimit çnjerëzor, grabitjes dhe shkatërrimit të pronës, të pasurive ekonomike, objekteve kulturore dhe religjioze dhe veprave penale të tjera të ngjashme, kanë ndodhur në territorin e Kosovës në shkallë të gjerë apo sistematike në kontekst dhe si rrjedhojë e zhvillimit të luftës (konfliktit), e cila ndodhi në periudhën kohore 1998 dhe 1999.

Sipas së drejtës ndërkombëtare, hetimi dhe ndjekja penale efikase dhe efektive e krimeve të rënda, përkitazi parimet e transparencës, lirisë nga ndërhyrja politike, respektimi i drejtave të njeriut dhe përgjegjësitë individuale penale, janë mjete thelbësore për përcaktimin e përgjegjësisë së kryerësve, vendosjen e drejtësisë për viktimat dhe palët e dëmtuara si dhe për forcimin e sundimit të ligjit.

Prokuroria Speciale e Kosovës i ka marrë kompetencat ekskluzive në qershor të vitit 2018 për t'i hetuar dhe ndjekur krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Fillimisht, këto raste ishin në kompetencë të prokurorëve të UNMIK-ut, më pastaj kishin kaluar në kompetencë të Misionit Evropian për Sundim të Ligjit, EULEX.

Që nga muaji qershor 2018 e deri më tani në Prokurorinë Speciale të Kosovës, konkretisht në Departamentin e Krimeve të Luftës, nga misioni i EULEX-it janë transferuar rreth 900 lëndë të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Gjithashtu, janë transferuar edhe rreth dy mijë lëndë për persona të zhdukur.

Për të pasur një hetim dhe ndjekje penale efikase dhe efektive, Strategjia për Trajtimin e Krimeve të Luftës parasheh përforcimin e Departamentit për Krime të Luftës në Prokurorinë Speciale me gjithsejtë pesë prokurorë dhe staf mbështetës, të cilët do t'u shërbejnë prokurorëve për trajtimin e lëndëve të krimeve të luftës.

Në bazë të strategjisë dhe numrit të lëndëve, të cilat janë në Prokurorinë Speciale, parashihet edhe rritja e numrit të zyrtarëve policorë të cilët duhet të kryejnë hetime në bazë të urdhrave dhe vendimeve të prokurorëve specialë.

MAShT-i dhe UNICEF-i me iniciativë për vizita nëpër familje mbi rëndësinë e edukimit të hershëm

PRISHTINË, 22 SHKURT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të premten në takim udhëheqësin e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Murat Sahin, me të cilin ka biseduar për mundësi të bashkëpunimit në procese të rëndësishme në arsimin parauniversitar.

Ministri Bytyqi fillimisht ka falënderuar UNICEF-in për mbështetje të vazhdueshme në arsim dhe për gatishmërinë që të ofrojë ekspertizë për hartimin dhe akreditimin e programeve të mbështetura në shkathtësi në edukimin formal të Kosovës.

Ministri ka theksuar rëndësinë e këtyre programeve për pajisjen me shkathtësi për jetë dhe punë të të rinjve, ndërsa ka shtruar nevojën e informimit të duhur për përfitimet që mund të kenë të rinjtë nga këto programe, sidomos nga programi UPShIFT, përmes të cilit ata mund të zhvillojnë shkathtësi teknologjike, inovative dhe kreative. Në këtë takim u bisedua edhe për angazhimet e përbashkëta të MAShT-it dhe UNICEF-it për parandalimin e braktisjes së shkollimit, po ashtu edhe për rëndësinë e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe nevojën për vetëdijesimin e prindërve përmes materialeve të ndryshme informuese lidhur me këtë çështje.

Ministri Bytyqi dhe udhëheqësi i UNICEF-it, Murat Sahin, u pajtuan që MAShT-i në bashkëpunim me UNICEF-in të fillojë një fushatë vetëdijësuese nëpër familje, ku do t'u ofrohet prindërve pako me informacione mbi rëndësinë e edukimit dhe shëndetësisë për moshat 0-3 vjeç.

PDK-ja bëhet anëtare e Aleancës së Konservatorëve dhe Reformistëve në Evropë

Qendresa RAMA

ROMË, 22 SHKURT - Gjatë takimit të Aleancës së Konservatorëve dhe Reformistëve në Evropë (ACRE) në Romë të Italisë u konfirmua formalisht anëtarësimi i Partisë Demokratike të Kosovës në këtë organizatë ombrellë që mbledh partitë konservatore të qendrës së djathtë që përbën lëvizjen politike me rritjen më të madhe në Evropë.

Në fjalën e tij pas formalizimit të anëtarësimit të PDK-së në ACRE, lideri i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ka theksuar se e shikon këtë anëtarësim jo vetëm si arritje, por edhe si përgjegjësi, duke premtuar se PDK-ja do të jetë një anëtare aktive dhe e dedikuar e kësaj organizate. Po ashtu, Veseli ka propozuar që një nga samitet e ardhshme të ACRE-së të organizohet në Prishtinë, ku do të kenë mundësi të njihen nga afër me arritjet e Kosovës si dhe me punën e PDK-së. Kjo organizatë (ACRE) bashkon partitë politike evropiane që promovojnë parime si liria individuale, sovraniteti kombëtar, demokracia parlamentare, sundimi i ligjit, prona private, qeveria e kufizuar, vlerat tradicionale të familjes, tregtia e lirë dhe konkurrenca e hapur.

Duke qenë se këto janë vlerat kryesore politike të Partisë Demokratike të Kosovës, lideri i saj, Kadri Veseli, e ka konsideruar një hap të natyrshëm futjen në këtë organizatë ndërkombëtare të partive politike evropiane. Veseli e ka konsideruar pjesëmarrjen në këtë organizatë ombrellë të partive të ngjashme të qendrës së djathtë si një hap të madh drejt konsolidimit të marrëdhënieve

ndërkombëtare të PDK-së. Përpos kësaj, me këtë anëtarësim PDK-ja çimenton orientimin e saj ideologjik si parti e djathtë që promovon ekonominë e tregut, inovacionin dhe vlerat konservatore të shoqërisë së Kosovës.

Nëpërmjet kësaj anëtarësie bëhet i mundur shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira mes partive të ndryshme konservatore. Po ashtu, ky anëtarësim ia jep mundësinë PDK-së që ta mbrojë dhe promovojë Kosovën në nivel ndërkombëtar duke ndërvepruar me parti anëtare të vendeve që ende nuk e kanë njohur Kosovën.

Çmimet e prodhimeve bimore dhe blegtorale shënuan rritje

EPOKA E RE A. MAVRAJ

Prishtinë, 22 shkurt - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi" për vitet 2015-2018 (2015=100). Sipas metodologjisë së Eurostatit, ASK-ja ka bërë ndërrimin e vitit bazë të indeksit nga 2010=100 në 2015=100. Për të bërë krahasime dhe për t'i vërejtur ndryshimet janë prezantuar të dhëna për vitet 2015-2018 dhe për vitin bazë 2015, (2015=100). "Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vende të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen. Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë", është theksuar në raportin e ASK-së.

Sipas ASK-së, në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe për prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale, çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në euro, kurse njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë. "Në vitin 2018 indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje për 6.8 për qind krahasuar me vitin 2017, kurse indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 0.6 për qind në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017. Indeksi i përgjithshëm i çmimeve të prodhimeve bujqësore ka rritje për 3.3 për qind për këtë periudhë. Në vitin 2018, indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje për 7.9 për qind krahasuar me vitin 2015. Kurse, indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 2.4 për qind në vitin 2017 krahasuar me vitin 2015. Indeksi i përgjithshëm vjetor i prodhimeve bujqësore ka rritje për 4.7 për qind në vitin 2018 krahasuar me vitin 2015", është thënë në raportin e ASK-së.

KRPP-ja shpërndan certifikata themelore profesionale për zyrtarët e prokurimit

Prishtinë, 22 shkurt (ER) - Kryetari i Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), Osman Vishaj, në fjalën përshëndetëse gjatë ceremonisë së shpërndarjes së certifikatave themelore profesionale për prokurim për vitet 2019-2021, ku janë certifikuar 37 zyrtarë të prokurimit, ka thënë se njohuritë e fituara nga ky program, zyrtarët do t'i zbatojnë në institucionet e tyre përkatëse, gjatë kryerjes së prokurimeve publike, si dhe dhënies së rekomandimeve adekuate, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit të prokurimit në Kosovë. "Besoj shumë se njohuritë e fituara nga ky program zyrtarët do t'i zbatojnë në institucionet e tyre përkatëse, gjatë kryerjes së prokurimeve publike dhe dhënies së rekomandimeve adekuate, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit të prokurimit në Kosovë", ka thënë kryetari i KRPP-së, Osman Vishaj.

Ai ka falënderuar IKAP-in për bashkëpunimin për realizimin e këtij trajnimi, duke theksuar se, sipas Ligjit të Prokurimit Publik, zyrtarët përgjegjës të prokurimit dhe nëpunësit e prokurimit fillimisht duhet të kenë një certifikatë të vlefshme themelore profesionale për prokurim në mënyrë që t'u lejohet t'i marrin përsipër detyrat e tyre. Edhe përfaqësuesit e USAID-it dhe të IKAP-it gjatë fjalës së tyre premtuan se edhe gjatë viteve

të ardhshme do të ofrojnë mbështetje për programet e trajnimit që KRPP-ja ka në plan për implementim.

Programi themelor profesional i trajnimit ka përfshirë 15 ditë trajnime për pjesëmarrësit dhe ka qenë i strukturuar në dhjetë module të trajnimit që kanë përfshirë ligjin, rregulloret dhe udhëzuesit për prokurim publik në Kosovë.

Bedri Istrefi zgjedhet kryeshef ekzekutiv i

Prishtinë, 22 shkurt - Bordi i Drejtorëve i Telekomit të Kosovës në mbledhjen e fundit unanimisht ka vendosur që për pozitën e kryeshefit ekzekutiv të kësaj kompanie të zgjedhet Bedri Istrefi. Bëhet me dije kjo përzgjedhje është bërë pas një procesi shumë transparent, të udhëhequr nga komisioni i caktuar nga Bordi i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës Sh. A. dhe në përputhje të plotë me Ligjin për ndërmarrjet publike. Fillimisht ky komision ka përzgjedhur kandidatët në listën e ngushtë dhe pas intervistimit të tyre ka ardhur në përfundim se kandidati që mori më së shumti pikë nga paneli intervistues për pozitën e kryeshefit ekzekutiv është Bedri Istrefi.

Tani rrymën mund ta paguani edhe online

PRISHTINË, 22 SHKURT (ER) - Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) ka lansuar këtë javë aplikacionin "eKesco", i cili u mundëson konsumatorëve t'i paguajnë faturat e energjisë elektrike online si dhe të jenë të informuar për çdo zhvillim që lidhet me furnizimin me rrymë. Aplikacioni "eKesco", i cili mund të shkarkohet në telefonat e mençur, ofron informata për faturat, borxhin e papaguar, shkyçjet dhe rikyçjet për ndërprerjet e rrymës për shkak të punimeve në rrjet dhe shumë informata të tjera.

Në KESCO thonë se përmes këtij aplikacioni synojnë ta përmirësojnë edhe më shumë shërbimin ndaj klientëve. "Ne jemi kujdesur që aplikacioni të jetë lehtë i qasshëm dhe i përdorshëm. Për këtë arsye, presim që ai të gjejë përdorim të gjerë te konsumatorët", ka thënë Naxhije Pajaziti-Arifaj, drejtoreshë e Komunikimeve në KEDS/KESCO. Sipas saj, ky aplikacion do t'u kursejë kohë konsumatorëve, të cilët nuk kanë më nevojë të shkojnë në zyrat e kompanisë për t'i bërë pagesat.

Ditët e fundit KESCO ka shpërndarë mijëra fletushka për t'i informuar qytetarët se si të regjistrohen në këtë aplikacion. Përdoruesit e telefonave me sistem Android këtë aplikacion mund ta shkarkojnë në PlayStore, ndërsa përdoruesit e telefonave iPhone mund ta shkarkojnë në AppStore.

Ndërpritet greva e kontrollorëve të trafikut ajror

PRISHTINË, 22 SHKURT (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj dhe kryetari i Shoqatës Sindikale të Kontrollorëve të Trafikut Ajror, Artan Hasani, të premten kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi, përmes të cilit i jepet fund grevës së paralajmëruar nga SINKON. Ky dokument përfshin kërkesat e parashtruara nga kontrollorët ajrorë pas përfshirjes së tyre në ligjin për paga.

Ministri Lekaj ritheksoi vendosmërinë e tij për angazhim maksimal deri në rregullim të statusit të veçantë për këtë kategori. Me anulimin e kësaj greve në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" vazhdojnë fluturimet, duke evituar çdo telashe që do të mund të sillte përsëritja e ndërprerjes së punës nga kontrollorët ajrorë.

NJË MARRËVESHJE E KEQE ASNJËHERË NUK PËRFUNDON MIRË

Behxhet Sh .
SHALA - BAJGORA

Kaosi i organizuar: Situata aktuale në Kosovë i ngjanë një kaosi të organizuar, të programuar dhe mirë të orkestruar. Asgjë nuk duket të jetë si duhet, por çdo gjë po funksionon, qoftë edhe në nivelin e mbijetesës. Ky është standardi ynë dhe kështu po krijohet një përshtypje se jemi në rrethin e VI-të të Ferrit, me kurorën e dafinave mbi kokat e vdekura politike dhe të atyre që do të vdesin qoftë për shkak të skadimit të afatit politik, qoftë për shkak të një over-doze politike! Askush nuk ka informata për ecurinë e bisedimeve me Serbinë dhe askush nuk ka informata se brenda cilët kufijve do të jetë Kosova ditën e nesërme. Luginasit e Preshevës kanë filluar ta shohin veten brenda Kosovës dhe, si pasojë e mashtrimeve ordinere, ata i kanë paketuar gjërat për një zhvendosje emergjente. Presidenti Hashim Thaçi po e luan lojën e dhunimit klasik duke zhvendosur temat, nga Trampi e deri te Ibrahim Rugova, Daci dhe Luta! Jam përcjellës i zhvillimeve politike (e kjo nuk nënkupton se marr vesh shumë në politikë) në Kosovë, që nga koha kur këndonim këngën: "Shoku Tito, ne të betohemi..." dhe "Fadil Hoxha në kali të bardhë...", por asnjëherë nuk kam lexuar diku se Ibrahim Rugova ka kërkuar korrigjim të kufijve, këmbim të territoreve apo të bëjë pazare me territor të Kosovës. Realisht, për Rugovën, më e afërt dhe më i pranueshëm ka qenë qëndrimi i autonomisë së Kosovës brenda kufijve ekzistues se loja me territor të Kosovës. Nexhat Daci dhe Lutfi Haziri, si vlera të shtuara politike dhe kombëtare dhe parashikues të zhvillimeve politike e që ne, vdekatarët e rëndomtë nuk i shohim, kanë kërkuar këmbim të territoreve! Ashtu deklarohen edhe sot prandaj Hashim Thaçi mbështetet në ekspertizat e tyre profesionale dhe aftësitë parashikuese. Hashim Thaçi ka luajtur dhe po luan top... me të gjithë duke ndërruar pozicionet politike, duke i ndryshuar kufijtë e Kosovës, ata të Kazakistanit, të Etiopisë, Somalisë dhe Tanzanisë. Tash, kur ka ardhur veja te dalja emergjente e që në shqip thuhet b..ë, po deklaron se baballarë të ndryshimit të kufijve janë Rugova, Daci dhe Luta. Rugova nuk ka mundësi ta demantojë apo vërtetojë këtë pohim të presidentit tonë legjendar, Daci është deklaruar për korrigjim të kufijve ndonëse institucioni që menedermethënë quhet Akademi e Shkencave dhe Arteve e Kosovës e që drejtohet nga Daci e ka kundërshtuar Thaçin për këtë aventurë të Don Kishotit! Luta po ndjehet krenar dhe kohëve të fundit po sillet si Hashim Thaç i vogël sa i përket korrigjimit - deformimit të kufijve të Kosovës.

Në prononcimin e tij të fundit, Hashim Thaçi ka deklaruar se ideja e tij origjinale është bashkëngjitja e Luginës së Preshevës Kosovës, pa dhënë asgjë, ide në të cilën nuk beson as vet presidenti, sado pehlivan (cilësim i Bacës Adem) që është! Si kërcënim të "pranverës apo Shëngjergjit", presidenti Thaçi e shkrepi se, nëse brenda vitit 2019 nuk arrihet një marrëveshje me Vuçiqin atëherë do të ketë përshkallëzim të situatës prandaj duhet të arrihet marrëveshja, pavarësisht pasojave për Kosovën. Kjo është një pordhë super e ftohtë e Thaçit e që nuk ka asnjë efekt, qoftë të drejtpërdrejt apo edhe kolateral! Pikërisht është e kundërta, marrëveshja e keqe e përkeqëson situatën në Kosovë dhe në rajon! Po kush po i mbron kufijtë e Kosovës sot?

1. Lidhja Demokratike e Kosovës: Kjo parti e ka mendjen si të fitojë pushtet apo postin e kryeministrit prandaj po flet vetëm për zgjedhje të parakohshme ndonëse, nëse krijohet mundësia pranon të bëhet pjesë e pushtetit edhe me shkurtim të procedurave duke u shndërruar në kurtizanë politike, kryesisht të PDK-së. Deri më tani PDK-ja ia ka ngritur dy herë këmbët LDK-së dhe pas një shkërdhimi për aq sa i është duhur, e ka lënë të lagur, pa asnjë emocion. A do të ketë edhe një shalim të tretë të LDK-së nga hamshori (ndonëse me potencë shumë të lodhët) PDK-ja, shpejt do ta shohim. Duket se LDK-ja vetëm mund t'i ndërrojë brekët politike, nga ato ku shkruan opozitë me, aktualisht tatu të përbashkët LDK-LV me një palë të përdorura si karem nga PDK-ja, me tatu të kryeministrit të ardhshëm.

Procesi i ndërrimit të brekëve thuaja ka filluar. Si akt fillestar se ka pranuar joshjen nga PDK-ja, LDK-ja ka filluar t'i ulë brekët ku, qartë po i duket prapanica e stërpërdorur deri më tani. Nuk është se LDK-ja i kundërshton bisedimet apo PDK-ja dhe se do t'i qëndrojë besnike LV. Besnikëria ndaj LV-së zgjatë aq kohë sa të binden nga miqtë ndërkombëtarë, si parti "institucionaliste" se duhet të bëjnë koalicion me dreqin dhe të birin ama ta kenë udhëheqjen të cilën, edhe nëse e marrin, të tjerët do të jenë udhëheqës të vërtetë. Kjo LDK siç është, pa lider dhe pa lidership, me shumë pretendentë, jo që nuk është në gjendje t'i mbrojë kufijtë e Kosovës por nuk janë në gjendje t'i mbrojnë as zyrat e saj. LDK-ja, po të kishte bol... politike dhe qëllim mbrojtjen e kufijve të Kosovës, do të organizonte për çdo ditë protesta, bashkë me LV-në kundër rrezikimit të integritetit territorial të Kosovës. Po ta bënte këtë, do ta kishin përkrahjen e pjesës dërmuese të qytetarëve të Kosovës. Kështu, përveç retorikës patriotike, përmbajtjen e ka puro luftë për pushtet.

2. Lëvizja Vetëvendosje: Kjo parti politike e ka përjetuar fatin e meteorit, nga rritja e madhe dhe ngritja në lartësi, ka filluar të përplaset për toke. Dhe po ka dhimbje të konsiderueshme si dhe humbje, në radhë të parë në njerëz. Kjo parti i futi në radhët e saj dështakët e FER-it dhe djajtë e Ferrit. Këta, në një moment të caktuar, ia hudhën LV-së duke ua marrë 12 deputetë në mesin e të cilëve gjysma ishin me të kaluar jugosllave, të konvertuar në nacionalistë kurse, gjysma tjetër të deklaruar si nacionalistë të bindur. LV-ja e proklamonte forcërisht bashkimin me Shqipërinë në kohën kur nuk qe në gjendje ta ruaj as tërësinë partiake. Kjo parti ka vija të kuqe vetëm për PDK-në, jo se nuk duan ta ndajnë pushtetin me ta por se nuk kanë besim se nuk do të mashtrohen nga PDK-ja. LV-ja nuk mund ta mbrojë integritetin territorial të Kosovës duke lidhur organizimin e protestave me shtatzëni, pra, duke organizuar protesta në çdo 9 muaj e që pastaj, 9 muaj të ardhshëm të merret me numrin e pjesëmarrësve në protesta. Situata aktuale në Kosovë mund të ndryshojë vetëm me protesta të përditshme dhe masive dhe për këtë duket se LV-ja nuk ka kapacitet të organizojë. LV-ja po gabon rëndë që po merret shumë me PSD-në sepse në këtë mënyrë po e faktorizon atë. Koalicioni LV-LDK është i panatyrshëm dhe jofunksional dhe nuk ka jetëgjatësi për shkak të ambicieve të pakapërcyeshme për të qenë i pari. Aq më parë kur dihet se: "dy atllarë (nëse janë të tillë) nuk lidhen në një mullar! Dhe kur lufta kryesore bëhet për mullarin.

3. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës: Kjo parti ka fituar më së shumti në zgjedhjet e fundit. Sidomos në konsolidimin e saj. E luajti lojën si duhet për të marrë postin e kryeministrit dhe e mori. Fuqia e kësaj partie nuk përcaktohet nga kapaciteti intelektual dhe politik por nga karizma e kryetarit të saj dhe nga kapaciteti destabilizues që e ka e që kjo, sipas një automatizmi nënkupton se ka edhe kapacitet stabilizues. Nëse më herët LV-ja kishte anëtarë që në çdo moment do të ishin në gjendje të sakrifikohen për liderin shpirtëror, Albin Kurtin. e që tash nuk e kemi këtë situatë, në AAK ka të tillë që janë në gjendje të sakrifikohen në çdo moment për Ramush Haradinaj i cili e ka ruajtur dhe madje e ka forcuar karizmën që e ka pasur. Me ardhjen në pushtet ka punësuar aktivistë partiakë e që te ne është kusht që ta marrësh dhe forcosh pushtetin. Qëndrimi ndaj Serbisë ka qenë infuzion shtesë e sidomos taksa prej 100 për qind (ndonëse ishte e PDK-së) për mallrat nga Serbia dhe Bosnja e ka ngritur shumë Ramush Haradinajn dhe AAK-në në skenën politike kosovare që është e folklorizuar më shumë se vet këngët e Dervish Shaqës dhe yllit në ardhje të folklorit pseudopolitik, Agim Bahtiri. Ramushin e ka forcuar dhe ia ka drejtuar shtyllën kurrizore sidomos qëndrimi i drejtë dhe parimor ndaj armiqve të Kosovës, Johanes Han dhe Federika Mogerini. Nëse zgjedhjet mbahen brenda 2-3 muajve, AAK-ja, në variantin më të keq del partia e tretë (3). Nëse zgjedhjet mbahen pas 9 muajve, politikisht AAK-ja humbë shumë. AAK-ja dhe Ramush Haradinaj duhet ta kuptojnë se taksa 100 për qind është masë e përkohshme dhe se kjo taksë nuk garanton ruajtjen e tërësisë territoriale të Kosovës. Tërësinë territoriale Ramushi mund ta mbrojë në dy mënyra; 1) duke qëndruar në pushtet dhe duke mos lejuar realizimin e çmendurisë për humbje të territorit e që nënkupton një marrëveshje me anëtarët e koalicionit për taksën dhe, 2) duke u larguar nga pushteti dhe duke u bërë bashkë me LV-në për të organizuar protesta të përditshme. Kështu, ky pat pozicion nuk mund të zgjasë shumë aq më parë kur ndërkombëtarët e gjithëpushtetshëm kanë mundësi të pamata për t'ju eliminuar nga pushteti. Unë flasë me komoditet sepse, as nuk jam pjesë e pushtetit sikur që nuk do të pranoja në asnjë rrethanë të bëhem pjesë e pushtetit prandaj shkruaj si të dua dhe kur të dua. Ju kujtohet që ndërkombëtarët, më parë nuk e lejonin të bëhej kryeministër, presidentin aktual historik Hashim Thaçi sepse thoni se i ka duart e papastra. Tash, kur ia pastruan trurin, nuk iu intereson nëse Hashim Thaçi i ka pastruar duart prandaj e lejojnë të sillet me Kosovën si me qenefin e arave apo kantiereve të ndërtimit. Ramush Haradinaj nuk ka shumë hapësirë manovrimi, madje e ka shumë të ngushtuar, ose duhet ta tejkalojë situatën e që unë nuk do ta bëja, ose duhet të kalojë në opozitë duke bërë "luftë" të përditshme me pozitën që identifikohet me Hashim Thaçin! Jam i bindur se

→

kjo gjendje do ta marr epilogun shumë shpejt. Unë jam fuqishëm pro taksës sepse e kam një komoditet të tillë për faktin se mua nuk më shkruan as Trampi, as Trapi, as Boltoni, as Mogerini (sidomos), as Shtrausi mashtrues Johanes Han, as kancelari Sebastian Kuraci i Austrisë dhe politikanë të tjerë. Unë nuk kam arsye të kalojë natën në ankth nëse ambasadori Kosnet do të ma zë derën në mëngjesin e ditës vijuese! Ramushi e ka situatën e qartë dhe vendimi është në duart e tij. E them publikisht se kundër korrigjimit të kufijve jam në gjendje të kundërshtoj në të gjitha format e mundshme dhe pa asnjë hezitim. Për këtë arsye, fuqishëm e përkrah Ramush Haradinajn sikur që do ta përkrahja edhe Rada Trajkoviqin nëse do e mbante këtë qëndrim!

4. Partia Demokratike e Kosovës: Kjo parti është në rënie por, për shumë gjëra në Kosovë është vendimmarrëse. Nuk është mirë me të sepse ta ngulin edhe kur nuk e pretë por as pa ta nuk po bëhet. Pyeteni LDK-në sepse ata e kanë përvojën e duhur. Kush e ka pësuar, mund edhe t'i besohet! PDK-ja e bëri taksën, PDK-ja po ia fut taksës! Jo për qëllime të përfitimit politik por se amerikanët po e kërkojnë këtë. Dhe, të gjithë e kanë të qartë se sa u përket mbrojtjes së parimeve, PDK-ja është vet Amerika! Madje, është më Amerikë se vet Amerika! Për ta vërtetuar këtë, ju përkujtoj se themeluesin e PDK-së, gjeodetin Hashim Thaçi nuk e kanë quajtur as Donald Tramp e lëre më Xhon Bolton por, me të drejtë e kanë quajtur Xhorxh Uashington. Kadri Veseli pranoi që Ramush Haradinaj të bëhet kryeministër i Kosovës duke shkaktuar pakënaqësi në radhët e PDK-së. Mendoj se ky ka qenë veprimi më i mirë politikë në atë kohë dhe për ato rrethana. Tash e kanë një vijë ndarëse me Ramushin për shkak të taksës. Besoj se Kadri Veseli nuk ka fare interesim ta rrëzojë nga posti Ramushin dhe ta fusë në qeveri LDK-në. Rrëzimi i Ramushit është dobësim i PDK-së kurse futja e LDK-së duke i dhënë poste do të ishte fuqizim i madh i LDK-së e besoj se PDK-ja nuk është në gjendje të lejojë një komoditet të tillë, forcimin e LDK-së në rrethana kur vet PDK-ja e ka marrë "vellika teposhtëzën". Aktualisht i shoh dy mundësi; E para që PDK-ja dhe partnerët e koalicionit të merren vesh me Ramushin për taksën duke votuar në qeveri për taksën, në marrëveshje me Ramushin dhe jo në kundërshtim të Ramushit dhe, e dyta që, nëse nuk ka marrëveshje atëherë PDK-ja të dalë nga qeveria, të bëhet opozitë duke i lënë Ramushit mandatin për gjetjen e partnerëve tjerë për formimin e qeverisë. Nuk ma kap mendja se Kadri Veseli dëshiron ta rrëzojë Ramushin sepse, po ta kishte këtë qëllim, moti do të harrohej puna e kësaj qeverie, me taksë apo pa taksë. As Hashimi nuk e ka këtë interes ndryshe, taksirati moti do të ndodhte! Tash, mos i besoni fort granimit të PDK-së; Xhevës, Blertës, Ganes etj. sepse, edhe zëri i gruas duhet të dëgjohet. Së paku në aspektin formal! Ndërkaq Kamishi, Fatmiri, Xhaviti dhe disa të tjerë, një kohë të gjatë kanë qëndruar në të njëjtin vend, janë mbushur me gazra prandaj duhet ta lëshojnë nga një, me kusht që nuk e dëmtojnë - kontaminojnë fort mjedisin. Ambasada amerikane i bënë matjet e pastërtisë së ajrit prandaj këta që i përmenda aq shumë thirren në Amerikën dhe amerikanët.

Korrigjimi i kufijve: Ndonëse e cilësoi si ide shumë të rrezikshme shkëmbimin e territoreve midis Thaçit dhe Vuçiqit, kancelari i Austrisë, Sebastian Kuraci tha se e përkrahin këtë, së bashku me presidentin Tramp, me kusht që dëshmitarë të jenë Johanes Han dhe Frederika Mogerini kurse noter të jetë Xhon Bolton.
Me korrigjimin e kufijve Serbia përfundimisht lirohet nga çështja shqiptare duke e spastruar Luginën e Preshevës etnikisht. Nga Medvegja Kosova mund ta marrë vetëm Leme Xhemën nëse ajo merr pushim pa pagesë në Kuvendin Komunal të Medvegjës, ku ishte e punësuar kur në Kosovë kërkohej të bëhej ministre për Infrastrukturë pas performancës së shkëlqyer në PTK. Nga Buajnoci dhe Presheva mund t'i marrim disa fshatra të banuara me shqiptarë, kultivues të dëshmuar të canabis sativa (mariauanë) e që do të ndikojë në hapje të vendeve të reja të punës përmes fuqizimit të ekonomisë së tregut. Ata pak shqiptarë që do të mbesnin atje, pas një kohe do të shpërnguleshin nga aty kur, edhe ashtu kanë probleme me dokumentacion të identifikimit.
Kështu, Serbia përfundimisht do ta zgjidhte çështjen shqiptare kurse institucionalisht do ta legalizonte në Kosovë çështjen serbe, si element strategjik destabilizues i cili do të mbrohej nga Kushtetuta e Kosovës të cilën serbët nuk e pranojnë! Veriu i Kosovës, me ndihmën bujare dhe kriminale të KFOR-it francez, në shkurt të vitit 2000 e bëri spastrimin e veriut të Kosovës nga shqiptarët dhe dhunshëm e ndryshoi strukturën etnike. UNMIK dhe EULEX e penguan dhe e pengojnë kthimin e shqiptarëve në pronat e tyre të cilat janë uzurpuar dhe plaçkitur nga serbët vendas dhe të ardhur. Pjesa dërmuese e serbëve vazhdojnë të jetojnë në jug të lumit Ibër, nuk e pranojnë Kosovën si shtet, duan të mbesin aty ku janë (kanë të drejtë) dhe pranojnë të manipulohen nga Serbia për qëllime politike. Këta serbë, së bashku me Asociacionin që do të formohet, me zonat e mbrojtura, me një kishë ortodokse serbe që konsideron më shumë se gjysmën e Kosovës pronë të saj dhe që ka mundësi të bëhet kategori kushtetuese, përjetësisht do ta bënin Kosovën jofunksionale dhe gjithmonë do ta aktivizonin masën kritike për destabilizim të Kosovës. Prandaj, ndonëse jam fuqishëm kundër korrigjimit të kufirit me Serbinë sipas parimit etnik, në radhë të parë, dhe se jam kundër çdo korrigjimi, nëse kjo na imponohet si zgjidhje e vetme atëherë të gjithë serbët duhet të barten në Serbi sikur që të gjithë shqiptarët duhet të barten në Kosovë. Zgjidhjet radikale nuk pranojnë zgjidhje parciale prandaj lërini marrëzirat e lojës me kufij të Kosovës. Le të jetojnë të gjithë në vendet ku kanë jetuar apo ku duan të jetojnë dhe zgjidhja është brenda kufijve ekzistues të Kosovës! Kush luan me kufijtë e Kosovës merr përgjegjësi të madhe, jo aq për veten sa për të tjerët. Hashim Thaçi nuk është Kosova dhe nuk ka të drejtë t'i konsiderojë këta kufij si pronë private. Hashim Thaçi dhe të gjithë të tjerët e kanë për detyrim ta mbrojnë Kushtetutën e Kosovës dhe asgjë më tepër.

Një lutje për Hashimin: Në takimin e radhës me Vuçiqin, të fshehtë apo publik, ju lutem që në emër të Behgjet Pacollit, Enverit, Dardanit, Shpendit dhe kotillës politike të Hashimit, t'ia uroni të bërit baba mashkullit më të fortë të Serbisë, kryeministres Ana Bërnabiq. Emrin nuk e ka të burrave por qëndrimin po. Ky është gëzim i madh për Serbinë dhe miqtë e saj sikur që këtë gëzim duhet ta ndajnë dhe përjetojnë edhe ata që me çdo kusht duan t'i normalizojnë marrëdhëniet me Serbinë. Mendoj se një ADN-së duhet të përcaktojë atësinë biologjike të djalit të babës Ana Bërnabiq, kryeministre e Serbisë. Kur po e shoh çdo ditë duke vajtuar, duke qarë e duke rrejtur, shokun e Hashimit, Acën e Serbisë, me një siguri mund të thuhet se baba biologjik i gruas së burrit Ana Bërnabiq, është pikërisht Aleksandar Vuçiq. Njeri më dyfytyrësh, më mashtrues dhe më gënjeshtar se Vuçiqin nuk mund ta gjeni. As në Serbi e as në Kosovë, ndonëse në Kosovë ka të tillë që edhe mund t'i hyjnë kësaj gare!

BESNIK BAJRAMI / KOSOVOTWOPOINTZERO.COM

—Pranvera Dobruna Kryeziu
External Energy Adviser to the Government of Kosovo; Lecturer on Energy Policy

Women in Energy

WE are creating new jobs in Kosovo. Women in Energy Scholarship Program by MFK will focus on providing opportunities for women in the energy sector, contributing to economic growth.

Pranvera Dobruna Kryeziu serves as the External Energy Adviser to the Government of Kosovo and as Chief Negotiator for the Kosovo-Serbia energy dispute. Ms. Dobruna Kryeziu was the first woman CEO of Kosovo's energy corporation.

Learn about our scholarships and find out how to apply using the link below.

millenniumkosovo.org/womeninenergy

Find us at:
Millennium Foundation Kosovo

9th floor of the former Ljubljana Bank Building
Migjeni Str. 21,
10000 Prishtina,
Republic of Kosovo

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

MILLENNIUM CHALLENGE CORPORATION UNITED STATES OF AMERICA

DMACC DES MOINES AREA COMMUNITY COLLEGE

U shënua 100-vjetori i masakrës së Malit të Zi dhe të Serbisë në Shtupeq dhe në katunde të tjera të Rugovës, më 1919

Zymer U. NEZIRI

Në Pejë, në Universitetin "Haxhi Zeka", në bashkorganizim me Klubin e Intelektualëve të Rugovës në Prishtinë, u mbajt simpozium shkencor në këtë 100-vjetor, më 15 shkurt 2019, për njërën ndër masakrat më mëdha të asaj kohe. Kumtuan studiues të përmendur, shumica nga qendrat tona universitare: dr. sc. Arben Arifi, Prishtinë, prof. Binak Ulaj, Plavë e Guci, prof. as. dr. Elinda Dibra (Ramadani), Shkodër, prof. dr. Fatmira Musaj, Tiranë, prof. as. dr. Fitim Rifati, Prishtinë, prof. dr. Hakif Bajrami, Prishtinë, prof. dr. Haki Kasumi, Prishtinë, prof. dr. Isamedin Azizi, Shkup, prof. dr. Limon Rushiti, Prishtinë, prof. as. dr. Luan Tetaj, Prishtinë, prof. dr. Lush Culaj, Prishtinë, akad. prof. dr. Marenglen Verli, Tiranë, dr. sc. Mark Palnikaj, Tiranë, dr. sci. Nail Draga, Ulqin, mr. sc. Nikollë Loka, Tiranë, prof. dr. Dom Nikë Ukgjini, Shkodër, dr. sci. Qerim Lita, Shkup, prof. Rexhep Dedushaj, Plavë e Guci, prof. as. dr. Rudina Mita, Elbasan, prof. dr. Shyqyri Hysi, Gjirokastër, prof. dr. Zymer Ujkan Neziri, Prishtinë. Pos kumtesave të lexuara, me interes ishin edhe diskutimet.

Në sallën e mbushur përplot janë shpërndarë libri Shkurtorja e kumtesave me programin e simpoziumit dhe libri Ditt e trishtimit... të Zef Mark Harapit, përgatitur për shtyp nga dom Nikë Ukgjini, ribotim i "Dukagjinit", dhuratë për nevojat e shënimit të këtij përvjetori.

U shpërnda edhe dokumenti i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, pjesa për Shtupeqin e Vogël dhe për Shtupeqin e Madh, me emrat e 433 dëshmorëve e martirëve të masakruar, të vrarë ose të djegur të gjallë nëpër shtëpia dhe në Hanin e Isuf Veselit, më 16 shkurt 1919. Mosha e tyre është nga fëmija një vjeç (djali i Shabanit, Sh. i Madh) e deri te plaku 101 vjeç (gruaja e Ibishit, Sh. i Madh). Ndër ta është edhe bajraktari i Bajrakut të Shtupeqit të Vogël, Mehmet Shabi - Pepënikaj, i plagosur gjatë luftimeve, i zënë rob në Lipë dhe i pushkatuar bashkë me ndihmësin e tij, Bekë Hyseni - Nilënikaj. Por, ka aty edhe disa emra personash që kanë shpëtuar, pra, janë shënuar gabimisht, mirëpo ka edhe emra që mungojnë. Dokumenti i KMKK-së, dt. 8 shkurt-25 shkurt 1919, është dorëzuar në Lidhjen e Kombeve, më 21 dhjetor 1921, me të dhëna për këto dy katunde dhe për katundet e tjera të Rugovës, si dhe për Plavën, Gucinë, Pejën, Gjakovën, Rozhajën. Versioni i tashëm, i botuar në rev. "Dy Drina", pjesa për Shtupeqin e

Vogël dhe për Shtupeqin e Madh, me emrat e 433 dëshmorëve e martirëve të masakruar, të vrarë ose të djegur të gjallë, është i përkthyer nga frëngjishtja dhe është përgatitur për shtyp nga Kujtim Nuro.

Të pranishmit i përshëndetën prorektori, prof. dr. Afrim Selimaj, dhe kryetari i KD të Klubit, prof. dr. Ali Muriqi. Në mbrëmje, në teatrin "Istref Begolli", në praninë e personaliteteve të njohura, u mbajt akademi përkujtimore, me drejtues prof. dr. Jeton Kelmendin, sekretar i Klubit, ku folën ministri Shyqyri Bytyqi, kryesuesi i Kuvendit, Islam Husaj, komandanti Salih B. Lajçi, prorektori Afrim Selimaj dhe Zymer U. Neziri, hartues i projektit. La mbresa të forta AFA "Rugova" me këngë e me valle të njohura epike, kurse Fatos M. Lajçi shfaqi një film dokumentar.

Të nesërmen kumtuesit vunë kurora pranë pllakave përkujtimore në Shtupeq dhe u thanë fjalë rasti nga Ramiz Beqir Nikçi, Avdi Hysë Halili dhe Haxhë Zenel Nikçi.

Kjo ishte një përpjekje për të larë borxh ndaj atyre rugovasve që u masakruan nga Serbia dhe Mali i Zi vetëm pse ishin shqiptarë. Kjo është po ashtu përpjekje për ndriçimin e mëtejshëm të historisë më të re të krimeve të Malit të Zi dhe të Serbisë mbi popullin shqiptar. Por, më kryesorja është që me këtë simpozium shkencor t'ia kujtojmë brezit tonë të ri rrugëtimin e përgjakshëm të të parëve tanë nën robëri, nga viti 1912 deri në qershor 1999, kur Rugova e Peja gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përsëri janë masakruar, janë plaçkitur e janë djegur nga Mali i Zi e Serbia. Mirëpo, deri më sot ato nuk kanë kërkuar falje për krimet, nuk i kanë kthyer eshtrat e të pagjeturve, as nuk i kanë paguar dëmet e shkaktuara, ndonëse luftën e kanë humbur. Madje, Malin e Zi e kanë shpërblyer 80 deputetë shqiptarë me afër një të tretën e territorit të krahinës së Rugovës, më 21 mars 2018, në Kuvendin e Republikës së Kosovës! Për kumtuesit u ndanë certifikata, kurse mirënjohje u dhanë për ata që e ndihmuan realizimin e projektit me punë dhe me mjete financiare. Kumtesat do të botohen. Do të botohet edhe një vëllim me dokumente. Në qershor planifikohet vënia e gurthemeleve të dy qendrave përkujtimore për periudhën e robërisë dhe të qëndresës, 1912-1999, në Shtupeq të Vogël dhe në Shtupeq të Madh.

Koordinatori Hoti takohet me drejtorët e shkollave boshnjake

PRISHTINË, 22 SHKURT (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti, është takuar të premten me udhëheqësit e institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prizrenit nga komuniteti boshnjak të cilëve ua shpalosi Programin Nacional për Rininë. "Me Programin Nacional për Rininë edhe nxënësit e komunitetit boshnjak do ta kenë mundësinë të jenë të barabartë në garë me moshatarët e tyre nga komunitetet e tjera. Po ashtu, në të ardhmen këta nxënës do të mund të garojnë edhe me moshatarët e komunitetit boshnjak në Bosnje, Sanxhak dhe Mal të Zi. Të gjitha dokumentacionet e programit

janë të përkthyera edhe në gjuhën boshnjake në mënyrë që ta sigurojmë gjithëpërfshirjen si pikë themelore të programit. Unë pres që nxënësit boshnjakë ta tregojnë frymën dhe shpirtin garues", ka thënë Hoti.

Koordinatori Hoti ishte i shoqëruar nga zëvendësministri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji nga radhët e komunitetit boshnjak Bajrush Sezairi, i cili ofroi mbështetje për programin. "Unë ju premtoj që ju do ta keni mbështetjen time për këtë program sepse është një mundësi e jashtëzakonshme për nxënësit e komunitetit boshnjak dhe jo vetëm. Jam shumë i lumtur që nxënësve tanë po u ofrohet mundësi për t'u përfshirë në garë pa dallim", ka thënë Sezairi.

Ndërkaq, drejtorët e shkollave e mirëpritën programin duke thënë se do t'u shërbejë për të mirën e përgjithshme.

Programi Nacional për Rininë do të zbatohet në të gjitha shkollat e Kosovës në tri nivele: nivelin shkollor, komunal dhe republikan i garave në dituri, kreativitet kulturor dhe mendim kritik, si dhe në sport. Për më shumë, në garë do të përfshihen rreth 340 mijë nxënës dhe rreth 110 mijë studentë të të gjitha komuniteteve. Gara në dituri do të zhvillohet nëpërmjet testeve në të gjitha lëndët e arsimit parauniversitar. Gara në kreativitet kulturor dhe mendim kritik do t'u mundësojë nxënësve dhe studentëve t'i shprehin aftësitë krijuese dhe fuqinë e mendimit nëpërmjet krijimeve kreative. Ndërsa, gara në sport do të zhvillohet në formë të kampionateve në pesë disiplina: atletikë, shah, volejboll, basketboll dhe futsall. Ndërkaq, Programi Ndërshtetëror për Rininë parasheh garat në nivel rajonal me shtetet e tjera ku përfshihet edhe Shqipëria dhe shtetet e rajonit.

Kanye West me ylber në kokë



Kanye West duket se ka shumë gjëra në mendje këto ditë. Këngëtari u pa në një shëtitje të enjten duke shkuar në zyrën e tij në Calabasas, me një model të ri dhe interesant flokësh. Stil mjaft i gjallë, me pak ngjyrë vjollcë, pak të gjelbër dhe ca të kuqe. Kanye edhe më parë ka realizuar dukje interesante me flokët e tij.

Edhe dy akuza të reja ndaj R. Kellyt



R. Kelly sapo është akuzuar për sjellje të pahijshme seksuale nga dy gra që treguan historitë e tyre për herë të parë. Sipas tyre, ato dolën publikisht ngaqë duan t'i inkurajojnë viktimat e tjera që të vijnë përpara gjithashtu. Gratë përfaqësohen nga Gloria Allred, e cila u tregua e ashpër ndaj këngëtarit në konferencën për shtyp të NYC, duke e akuzuar për përdorimin e famës së tij për t'i manipuluar dy adoleshente në vitin 1995.

Selena Gomezi shkëlqen në martesën e shoqes

Këngëtarja Selena Gomez ka marrë pjesë në dasmën e shoqes së saj, Courtney Barry. Gomez pati të veshur një fustan të zi me material të lëkurës. Ky fustan i rrinte shumë mirë këngëtares.

Aktori amerikan që inskenoi sulmin mbi veten del para gjykatës

Aktori amerikan Jussie Smollet ka dalë para gjykatës. Ai është arrestuar të enjten pas dyshimeve se ka inskenuar një sulm fizik ndaj vetes, shkruan "Euronews". Këtë veprim Smollet e kishte bërë pas pakënaqësive rreth pagës. Pastaj në polici kishte bërë deklarim të rremë. Ai kishte paguar dy vëllezër nigerianë që ta përgatisnin sulmin.

Autor: GAZMEND MORINA

FATKEQËSI E MADHE, KOB
PJESË E ILIRISË
SËPATË E VOGËL
FAZAT
HIT NGA GRUPI MUZIKOR "NRG BAND"
BASHKËT.
PËREMËR PRONOR
RRETHI QË VIHET NË NJË BOSHT DHE QË RRO-TULLOHET
SHKRIMTARJA KADARE
PERANDOR ROMAK
EPOKA E RE

AKTORJA ANGLEZE NË FOTO
RAMADAN AVDIU
GJENDJE PLOGËSHTIE SHPIRTËRORE
BOJAXHI
VIGAN
I THAVA / RAPSODI HASHIM ....
QULL I TRASHË ME MIELL MISRI
ASSOCIATION NEWS ONLINE / SHTET NË AMERIKË
ISH FUTBOLLISTI ..... RRAKLI (shq.)
EPOKA E RE
IPSVICH / QYTET I MADH NË GJERMANI
ARSENAL / LLOJ MINERALI (shq.)
ANITA KOSUMI / KLUB FUTBOLLI NË SPANJË
TENISTJA KURNIKOVA / SHTIRËSI
ZANORE
ZBUKUROJ ME STOLI / ARBEN MALAJ
ILION LIKA / SMIRË
NJË E HAPUR E NJËRËS KËMBË PARA
KËNGËTARI ..... ARIFI / DESPOTI
TOTENHAM / KËNGËTARJA E FAMSHME ..... CAREY (shqip.)
EPOKA E RE
KEQTINGË-LLIM
ZAKON, TRADITË
AKTORJA E FAMSHME ..... CRUZ (shqip.)
ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk. orgj.)
VOZË E MADHE DRURI QË SHËRBEN PËR TË MBAJTUR DJATHË
E PESHOVA / ERMELINDA MEKSI
KRYEHOXHA / AKTORJA AMERIKANE ... FARIS
KOMANDANTI I NJË ANIJEJE
LUMË I MADH NË HUNGARI / TREGU
NJË PLANET
ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË
MJET I VOGËL KUZHINE / KURIFI, CAKU
DAFINË (shq.) / KAFSHË GJITARE BREJTËSE
AKTORI TURK IMIRZALIOGLU
NOTË MUZIKORE / KORNIZË
METODË STUDIMI / BASKETBOLL-ISTI TURK OMER
NJËRA NDËR TRI GJINITË KRYESORE TË KRIJIMTARISË LETRARE
OVERLAND TRAIL ELEMENTARY
SHTET FEDERAL NË SHBA / NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE
EDI MARFI / BERAT LUZHA
"JEMENI" / UDHËHEQËSI I NJË PARTIE
BASHKËT.
I LARMI / MODELJA KRASNIQI
BEDRI PEJANI / ISH PORTIERI GJERMAN OLIVER
LAMBERT ACADEMIC PUBLISHING / KËNGËTARJA .... ISTREFI
GAZ QË PËRDORET PËR TË PASTRUAR MIRË PLAGËT
KËNGËTARJA .... KONÇI / FILMI I PARË SHQIP
AKTORI HOLLIVUDIAN XHORXH ..... / FILOZOFI GJERMAN IMANUEL
ZANORE / I FILLOVA
RUBË, MARAMË (sh.shq.)
AKTORJA ..... KURTI / TAJVANI, INDONEZIA
TENISTI I FAMSHËM ENDI ..... / AQ SA DUHET (krah.)
INDIUM
MBARËSIA / GATESA
PUSIA
AGENCIA NACIONAL TRANSITO / BËRJA MË I RI
AKTORJA AMERIKANE .... SOFER / FUTBOLLISTI RAFAEL ..... (Real Madrid)
EPOKA E RE
TË DHËNËT SHPIRT, HEKË / FAQJA E PJERRËT E NJË MALI
FOSFOR, RADIUM, AZOT / EMINE (perkdh.)
DËMTIM I NJË MAKINE GJATË PUNËS / ENI LENOKS
NITROGJENI
BASHKËT.
TOKA E BUKËS / AKTORI ZHITOPOTOKU
SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE / AKTORI AM. SANDLER
REGJISORI ... QOSJA / KASOLLE PËR KAFSHËT
SHPEND ME QAFË TË GJATË E ME SQEP TË MADH
"ASHTU QOFTË" / KËNGËTARJA ... KOÇI
NJOLLA / KOHË
AGIM ZAJMI / PATRIOTI BOLETINI
SHOUMENI ... KRASTA
BOTIM / ELIZABETH TAYLOR
SHAKA, SHPOTI / "RISANI"
ZANORE / EDI RAMA
PËRSHËNDE-TJE ALLATURKA NË SHENJË NDERIMI TË THELLË
HYJNI E DASHURISË (mit. romake) / INTER
FEMRAT E SAPOMART-UARA / NANCY
KOPJIMI
RRUGËTIMI I TRENAVE

E rrallë

Delfini shitet për mish në Kinë, banorët e filmojnë duke qarë

Një delfin është filmuar në një moment tepër të dhimbshëm ku duket sikur ka lot në sy. Kafsha po shitej për mishin e tij në një market në Kinë dhe duket se e kuptoi këtë gjë. Delfini u shit me 2.2 paund për kilogramë. Gjitari u gjet në Azinë Lindore dhe është listuar si një 'specie në zhdukje' nga lista e Iucn Red.

Tregtia e kafshëve është e kontrolluar rreptësisht nga konventa kombëtare dhe e ndaluar në Kinë.

FOTO E DITES



Një plak shihet duke ngjyrosur një pëlhurë në Nigerinë veriore. /AP/

E jashtëzakonshme

Bleta më e madhe në botë është gjallë

Bleta më e madhe në botë është zbuluar përsëri, pas disa dekadash që mendonin se kishte humbur. Bleta gjigante, e cila është sa gishti i një të rrituri u gjet në një ishull në Indonezi. Pas disa ditësh kërkime, ekspertët e kafshëve të egra gjetën një bletë të vetme të gjallë, të cilën e fotografuan dhe filmuan. Bleta njihet si "Wallace"

pasi u zbulua nga eksploruesi britanik, Alfred Russel Wallace, i cili e përshkroi atë në vitin 1858.

BARSOLETA E DITËS

I vdiq gruaja dhe i shoqi porositi që në pllakën e varrit të saj të shkruhej: "E di që lotët e mi nuk të ringjallin, prandaj edhe qaj".

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Ata që po kërkojnë nga ju gjëra të caktuara nuk po ju specifikojnë se çfarë duan. Kjo paqartësi do të krijojë probleme në komunikim.



DEMI
Nëse sot nuk dëshironi të bëni më tepër seç ju kërkohet keni gjithë komoditetin për të mos vepruar. Dita do të shkojë qetë dhe pa ndonjë zhvillim.

BINJAKËT
Do të kërkoni të pushoni sot nga ngarkesa e javës. Keni menduar një fundjavë të këndshme dhe larg zhurmave të qytetit.

GAFORRJA
Keni lënë shumë pas dore aspektin tuaj social, por tani është pikërisht koha për t'u marrë sa më shumë me evente dhe aktivitete sociale.

LUANI
Sot po prisni që t'ju nxjerrin jashtë nga plogështia që ju ka kapluar. Një ftese nga miqtë do të vijë pikërisht në momentin e duhur.

VIRGJERESHA
Mënyra më e mirë për të qenë afër dikujt është t`i qëndroni pranë fizikisht edhe pse mund të mos flisni. Do të ndjeni mirënjohje karshi jush.

PESHORJA
Keni kuptuar që me kalimin e kohës ndryshojnë gjërat dhe njerëzit. Thjesht do t`ju duhet të përshtateni me risitë që sjell dita.



AKREPI
Nëse doni që persona të caktuar të tolerojnë lidhur me çështje të përbashkëta edhe ju reciprokisht duhet të bëni të njëjtën gjë.

SHIGJETARI
Keni dyshime mbi një person të caktuar dhe po prisni që nga momenti në moment të bëjë një hap fals për të vërtetuar dyshimet tuaja.

BRICJAPI
Mos kini frikë për çfarë ju sjell e ardhmja sepse në çdo rast ju i keni marrë masat të mos gjendeni keq nga ana financiare.

UJORI
Gjithçka rreth e qark jush ju shtyn të merrni sa më shpejt një vendim. Por, ju jeni tip që i besoni shumë kohës dhe vendimeve të matura.



PESHQIT
Provoni të bëni disa hapa pas nëse shikoni që një hap para nuk ju ka funksionuar. Do të mund të përmirësoni situatën tuaj karshi eprorëve.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	BURNLEY - TOTTENHAM	2	TORINO - ATALANTA	2	SEVILLA - BARCELONA	2

'Dardanët' kërkojnë fitore ndaj Rumanisë

Përzgjedhësi Damir Mulaomeroviq ka paralajmëruar se Kosova të dielën synon fitore ndaj Rumanisë. "Jam shumë i lumtur me atmosferën e shkëlqyeshme që është duke mbretëruar në Përfaqësuese. Djemtë kanë punuar me përkushtim të madh gjatë këtyre pesë ditëve dhe mund të them se për kaq ditë kemi arritur të bëjmë shumë gjëra së bashku. Rumania ka një ekip shumë të mirë, por ne duam ta fitojmë këtë ndeshje", ka thënë Mulaomeroviq. Ndeshja zhvillohet në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 22 SHKURT - Përzgjedhësi i Kosovës në basketboll, Damir Mulaomeroviq, ka thënë se atmosfera në Përfaqësuesen e Kosovës në basketboll para ndeshjes me Rumaninë është shumë e mirë. Sipas tij, "Dardanët" në ndeshjen e Grupit B të parakualifikimeve për "Eurobasket 2021" kërkojnë fitore, ani pse rumunët kanë një skuadër shumë të fortë. "Jam shumë i lumtur me atmosferën e shkëlqyeshme që është duke mbretëruar në Përfaqësuese. Djemtë kanë punuar me përkushtim të madh gjatë këtyre pesë ditëve dhe mund të them se për kaq ditë kemi arritur të bëjmë shumë gjëra së bashku. Rumania ka një ekip shumë të mirë, por ne duam ta fitojmë këtë ndeshje", ka thënë Mulaomeroviq. "Të dielën basketbollistët tanë do të dëshmojnë se janë luftëtarë të vërtetë dhe shfrytëzoj rastin t'i ftoj tifozët të vijnë në numër sa më të madh, sepse me të vërtetë kemi nevojë për përkrahjen e tyre, por edhe mendoj se këta djem e meritojnë përkrahjen e të gjithëve. Shpresoj se do të jetë një ndeshje me basketboll cilësor, sepse si ekip kemi pasur disa zhvillime dhe e kemi vendosur një standard në ekip, e kjo është për t'u lavdëruar për një përfaqësuese të re si Kosova", ka deklaruar Mulaomeroviq.

Për ndeshjen ndaj rumunëve ka folur edhe kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha. Kapiteni i "Dardanëve" ka premtuar maksimumin në këtë ndeshje në mënyrë që Kosova të dalë fituese. "Ndeshja është e një rëndësie të veçantë, andaj besoj se 100 % do të jemi të gatshëm për të dielën. Jemi duke stërvitur mjaft mirë, atmosfera është shumë e mirë, gjithçka po shkon sipas planit të paraparë. Lojtarët që për herë të parë janë pjesë e Përfaqësueses na kanë dhënë një energji të re dhe një motivim. E dimë mjaft mirë për çka jemi duke luajtur, do të luajmë para shikuesve tanë si vendës, do të japim gjithçka nga vetja për ta fituar këtë ndeshje, e cila nuk do të jetë e lehtë. Rumania ka përvojë, por ne si ekip çdo ditë po e ngrehim nivelin e lojës sonë", ka thënë Berisha, i cili ka bërë thirrje që të dielën palestra të jetë e mbushur në mënyrë që të motivohen sa më shumë lojtarët për fitore.

Ndërsa drejtori i përfaqësueseve të Kosovës, Granit Rugova, në prag të ndeshjes me Rumaninë, ka deklaruar: "Secila ndeshje ka rëndësinë e vet. E tillë do të jetë edhe kjo me Rumaninë, andaj u bëj thirrje të gjithë adhuruesve të sportit që të dielën të vijnë në numër sa më të madh për të na mbështetur, sepse kemi nevojë për përkrahje sa më të madhe të tifozëve. 'Dardanët' do të jenë të pranishëm në palestër në mënyrë të organizuar dhe tani na ka mbetur që të gjithë së bashku të kontribuojmë për të arritur deri te fitorja. Ekipi është shumë i motivuar për këtë ndeshje, andaj ne hyjmë në fushë për të fituar". Kosova, që bën pjesë në Grupin B në tri ndeshjet e para, ka pësuar humbje dy herë nga Maqedonia dhe një herë nga Rumania, ndërsa e ka edhe një shans në muajin gusht për ta siguruar një vend për në kualifikime për "Eurobasket 2021". Raundi shtesë i parakualifikimeve për "Eurobasket 2021" do të zhvillohet prej 3 deri më 21 gusht, ndërsa emrat e kundërshtarëve Kosova do t'i mësojë në shkurt, pas ndeshjes kundër Rumanisë.

Gjilani synon maksimumin ndaj Flamurtarit. Sot fillon edhe Liga e Parë

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 22 SHKURT - Sot (e shtunë) zhvillohen tri ndeshje të javës së 19 në IPKO Superligën e Kosovës. Një nga ndeshjet që pritet të zgjojë interesim të madh është ajo në mes të Gjilanit dhe Flamurtarit. Vendësit që në këtë ndeshje drejtohen nga Alban Hyseni, i cili e ka zëvendësuar trajnerin e larguar Sadat Pajaziti, kërkojnë t'u rikthehen fitoreve pas humbjes në xhiron e kaluar nga Drita (3-1). "Kemi punuar intensivisht këto ditë për ta kthyer moralin, motivin dhe atmosferën brenda skuadrës. Besoj se kemi arritur sukses, sepse ekipi duket mjaft i motivuar për t'u futur në fushë dhe për të treguar sa vlejmë dhe sa mundet. Gjendja fizike dhe psikike tanimë është e mirë dhe të gjithë e kemi mendjen te ndeshja e radhës, e cila ka peshën e vet dhe është mjaft e rëndësishme për ne për vazhdimin e kampionatit", ka thënë për faqen e klubit të Gjilanit, Ylber Kastrati. "Ne gjithmonë jemi mbështetur dhe do të vazhdojmë të mbështetmi te thënia 'të bashkuar jemi më të fuqishëm'. Besoj se me përkrahje

nga tribuna dhe me angazhim maksimal të bashkëlojtarëve të mi do të dalim me maksimum nga kjo sfidë dhe t'i bëjmë të ndihen të kënaqur me ne", ka shtuar kapiteni Kastrati.

Ndërsa Flamurtari, pas fitores në xhiron e parë të sezonit pranveror ndaj Prishtinës, po synon ta vazhdojë serinë me rezultate pozitive. "Kemi punuar shumë në fazën përgatitore. Kemi pasur edhe kushte të mira. Fitorja ndaj Prishtinës do të jetë një motiv shtesë për ne, por duhet të përqendrohemi në ndeshjen ndaj Gjilanit që të kemi një vazhdimësi me rezultate pozitive", ka thënë Alban Shillova, sulmues i Flamurtarit.

Sot (e shtunë) zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera, kurse tri ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje zhvillohen të dielën. Derbi i kësaj xhiroje zhvillohet në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas në mes të Feronikelit dhe Llapit. Ndeshje interesante pritet të zhvillohet edhe në stadiumin "Fadil Vokrri" në mes dy rivaleve të vjetra, Prishtinës dhe Lirisë. Ndërsa sot (e shtunë) fillon edhe sezoni pranveror në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Ndeshja kryesore për këtë xhiro do të jetë ajo në mes të Vitisë dhe Besës së Pejës. Të gjitha ndeshjet e Superligës dhe Ligës së Parë do të fillojnë nga ora 13:00.

SUPERLIGA

Të shtunën takohen:
Drenica - Ferizaj
Gjilani - Flamurtari
Ballkani - KEK-u

Të dielën takohen:
Feronikeli - Llapi
Trepça '89 - Drita
Prishtina - Liria

LIGA E PARË

Të shtunën takohen:
Ramiz Sadiku - Dukagjini
Trepça - Fushë-Kosova

Të dielën takohen:
Onix - Drenasi
Vëllaznimi - 2 Korriku
Arbëria - Vushtrria
Kika - Bashkimi
Vllaznia - Istogu
Vitia - Besa

Majlinda, e artë në Gjermani

PRISHTINË, 22 SHKURT - Kampionia Olimpike, Majlinda Kelmendi, e ka fituar medaljen e artë në Grand Slamin e Dusseldorfit. Xhudistja e Kosovës ka dominuar absolutisht ndaj kundërshtareve, kurse në finale e ka mposhtur xhudisten nga Mongolia, Sosorbaram Lkhagvasuren. Me këtë rast, xhudistja pejane e fitoi medaljen e dytë të artë në vitin 2019 pas asaj të fituar në Grand Prix të Tel Avivit. Në gjysmëfinale, Kelmendi e kishte mposhtur xhudisten italiane Odette Giuffrida me ippon në kategorinë deri në 52 kilogramë. Majlinda e kishte mposhtur italianen edhe në finalen e madhe të Lojërave Olimpike "RIO 2016". Në çerekfinale Majlinda e mposhti xhudisten koreane Bokyeong Jeong, gjithashtu me Ippon. Fillimisht, kosovarja ishte duke humbur me rezultat teknik, mirëpo afër fundit të meçit ajo u tregua shumë e fortë për kundërshtaren e saj, e cila tentonte ta sigurojë një vend në gjysmëfinale duke humbur kohë. Në rrethin e tretë, xhudistja pejane e mposhti xhudisten braziliane Eleudis Valentim, ndërsa në rrethin e dytë triumfoi kundër xhudistes gjermane Verna Thumm. Të dyja këto meçe, në rrethin e dytë dhe të tretë, Kelmendi i kaloi duke i mposhtur kundërshtaret me Ippon, ndërsa rrethin e parë e kaloi pa luftë. Në Grand Slamin e Gjermanisë po marrin pjesë 683 garues nga 97 shtete. Grand Slami është i vlefshëm për pikë Olimpike Tokio 2020.

Fitojnë Goden State dhe LA Lakers

Los Angeles, 22 shkurt - Pas pauzës së shkurtër për All Star Game, janë rikthyer ndeshjet emocionuese të NBA-së. Tashmë ka nisur faza kyçe e sezonit të rregullt, e cila përcakton përfundimisht ekipet që do të jenë pjesë e "play-off"-it. Gjashtë ndeshje u luajtën, të cilat dhuruan mjaft emocione. Në parket zbriti edhe kampioni në fuqi, Golden State Warriors, i cili vuajti për të fituar 125-123 ndaj Sacramento Kingsit. Stephen Curry realizoi 36 pikë, duke qenë i saktë në 10 nga 16 tentativat për tri pikë. Los Angeles Lakersi triumfoi 111-106 ndaj Houston Rocketsit, edhe falë LeBron Jamesit që realizoi 29 pikë dhe 11 "rebounde".
Rezultatet: Cleveland C.-Phoenix S. (111-98), Philadelphia 76ers - Miami Heat (106-102), Brooklyn N.-Portland Trail Blazers (99-113), Milwaukee Bucks - Boston C. (98-97), Golden State Warriors - Sacramento K. (125-123), Los Angeles Lakers - Houston R. (111-106).

Gashi: Palestrën e Rahovecit e testojmë më 27 shkurt

"Ndodhem për herë të tretë në Rahovec, në këtë palestër sportive. Jemi në fazën përfundimtare të kryerjes së punimeve. Kjo palestër brenda pak ditësh do të jetë e gatshme për të zhvilluar gara", ka thënë ministri Gashi

Rahovec, 22 shkurt - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i shoqëruar nga kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka vizituar palestrën sportive në Rahovec për t'i parë punimet e realizuara deri më tani në këtë objekt sportiv, projekt kapital në të cilin MKRS-ja ka investuar. Ministri Gashi ka deklaruar se ndodhet në këtë palestër për t'i parë nga afër punimet e realizuara deri më tani në këtë objekt sportiv dhe për ta rikonfirmuar përkushtimin e tij për mbështetjen e vazhdueshme që kjo palestër të përfundohet sa më parë. "Ndodhem për herë të tretë në Rahovec, në këtë palestër sportive. Jemi në fazën përfundimtare të kryerjes së punimeve. Kjo palestër brenda pak ditësh do të jetë e gatshme për të zhvilluar gara", ka thënë ministri Gashi. "Natyrisht se puna më e madhe është kryer në këta tre-katër muajt e fundit prej kur jemi marrë vesh me kryetarin Latifi që ta kemi të gatshme palestrën për zhvillimin e Kupës së Kosovës në basketboll. Është një moment jashtëzakonisht i mirë që përmes këtyre garave ta testojmë palestrën e Rahovecit", theksoi tutje ministri, duke vlerësuar se është fat i mirë dhe ditë e madhe për Rahovecin, për sportistët e sportdashësit, që ta kenë një projekt kaq të madh i cili ka një vlerë rreth tre milionë euro. Ministri shpjegoi se palestra do të ketë një kapacitet me 2 200 ulëse statike, me mundësi të ulëseve teleskopike, nëse do të jetë e nevojshme. "E kemi edhe një fazë të fundit për të përfunduar në tërësi projekti dhe kjo palestër do t'u dorëzohet juve si kryetar i komunës dhe përmes juve sportistëve dhe të gjithë qytetarëve të Rahovecit", tha ministri duke pohuar se është palestra e dytë këtë vit që do të inaugurohet në Kosovë.
Ministri ka deklaruar se këtë vit do të përfundohen edhe palestrat e tjera, punimet në të cilat kanë zgjatur me vite. "Do të punojmë me përkushtim të madh që t'i finalizojmë projektet e mbetura me vite", ka shtuar ministri Gashi.
